



Prishtinë: 03.04.2009
Kodi i ZRRE-së: V_163_2009

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
3. Kërkesën e KQKO për amendamentimin e Kodit të Pajisjeve Elektrike, Neni 3.2 dhe Neni 17.4.2.2 të datës 13 shkurt 2009,

në seancën e mbajtur më 01.04.2009 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **I lejohe**t KOSTT SH.A. amendamenti i nenit 3.2 dhe nenit 17.4.2.2 të **Kodit të Pajisjeve Elektrike**, si në **Shtojcë të** këtij vendimi.
2. Të gjitha dispozitat tjera të Kodit do të mbesin në fuqi.

ARSYETIM

ZRRE me datë 13 shkurt 2009 ka pranuar kërkesën e KQKO për amendamentimin e nenit 3.2 dhe nenit 17.4.2.2 të **Kodit të Pajisjeve Elektrike**. ZRRE gjatë vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh nevojën për investime në sistemin e transmisionit të cilat janë të lidhura me nenet e mësipërme të Kodit të Pajisjeve Elektrike ka parë të arsyeshme që të lejojë amendamentimin e këtyre neneve si në shtojcë dhe me vërejtjen për nenin 3.2 që **Kohëzgjatja e prishjes** në parim pranohet të jetë **1s**, por për çdo projekt veç e veç të analizohet nevoja e vendosjes eventuale në **3s**.

3. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



6. Vendimit i bashkëngjitet Shtojca:
- Arsyetimi dhe sqarime për ndryshime.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar